



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 25 mars 2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica dhe Ismet Beqiri.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Dren Ajeti – GLPS, Lumnije Murati – ZPRK, Kenan Gashi – AVONET, Mërgime Kajtazi – KDI, Agnesa Haxhiu – KDI, Dhurata Kryeziu – OSBE dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 13 tetor 2015, 21 janar 2016, 16 dhe 25 shkurt 2016;
3. Miratimi i planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961);
5. Informatë nga vizita zyrtare e delegacionit të Komisionit;
6. Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për pozitën e ambasadorit;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 13 tetor 2015, 21 janar 2016, 16 dhe 25 shkurt 2016

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet të mbledhjeve të mbajtura më 13 tetor 2015, 21 janar 2016, 16 dhe 25 shkurt 2016.

3. Miratimi i planit dhe programit të punës së Komisionit për vitin 2016

Elmi Reçica për planin dhe programin e punës së Komisionit për vitin 2016 tha se kemi diskutuar edhe në mbledhjet e mëparshme, ku secili anëtar i Komisionit ka kontribuar me propozimet e tyre. Plani dhe programi i punës së Komisionit ka ngelur që vetëm të miratohet formalisht.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Plani dhe programi i punës së Komisionit për Punë të Jashtme për vitin 2016.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961)

Enver Hoxhaj i njoftoi të pranishmit se projektligji u është shpërndarë të gjithë deputetëve, dhe se sipas procedurës së paraparë në Rregulloren e Kuvendit, projektligjet për ratifikim të marrëveshjeve i nënshtrohen vetëm një leximi.

Po ashtu njoftoi se qëllimi i këtij projektligji është heqja e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja. Republika e Kosova e ka depozituar instrumentin e aderimit në këtë konventë më 6 nëntor 2015, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës, si shtet depozitues i kësaj konvente.

Përmes aderimit në këtë konventë, kryetari tha se Republika e Kosovës avancon statusin e saj në arenën ndërkombëtare për të qenë e pranishme në forumet ndërkombëtare shumëpalëshe. Konventa Aposile e Hagës, i lehtëson procedurat e formaliteteve burokratike që obligojnë qytetarët dhe bizneset në shtetet kontraktuese anëtare të konferencës së Hagës për të drejtat ndërkombëtare private për të dëshmuar vërtetësinë e dokumenteve zyrtare të tyre.

Pas diskutimeve lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961), kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet Projektligji për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961).

5. Informatë nga vizita zyrtare e delegacionit të Komisionit

Teuta Rugova në cilësinë e kryesueses së delegacioni të Komisionit, i njoftoi për vizitën zyrtare të zhvilluar në Republikën e Italisë dhe në Republikën e Hungarisë. Në Republikën e Italisë delegacioni u takua me Komisionin për Politikë të Jashtme dhe Komunitetin të Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit të Italisë, si dhe me kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Emigracion të Senatit të Italisë. Në këto takime Rugova tha se i kemi njoftuar me punën që bëjmë në Komision, me gjendjen aktuale në Kosovë, me të arriturat e shtetit të Kosovës, si dhe iu është bërë ftesë për vizitë në Kosovë.

Lidhur me vizitën zyrtare të delegacionit të Komisionit në shtetin e Hungarisë, zonja Rugova i njoftoi se janë zhvilluar takime me Komisionin për Punë të Jashtme, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, si dhe me nënkryetarin e Parlamentit të Hungarisë. Në këto takime, është falënderuar shteti hungarez për ndihmën që ia ka ofruar Kosovës në fusha të ndryshme, është biseduar për formimin e grupeve të miqësisë, si dhe nevojën e avancimit të bashkëpunimit.

Qerim Bajrami lidhur me vizitën theksoi se delegacioni i Komisionit e ka arritur qëllimin e kësaj vizite. Këto vizita kanë qenë të suksesshme dhe duhet rritur bashkëpunimin në mes të këtyre parlamenteve. Ne u kemi bërë ftesë përfaqësuesve të dy parlamenteve që të vizitojnë Kosovën. Njëkohësisht falënderoi ambasadat tona në Romë dhe Budapest që ishin në nivel të detyrës dhe e përcjellën delegacionin gjatë gjithë vizitës.

Blerta Deliu-Kodra lidhur me vizitën zyrtare të delegacionit të Komisionit, i njoftoi se është ri konfirmuar nga të dy palët mbështetja e vazhdueshme e procesit integruar të Kosovës. Zonja Deliu-Kodra tha se ka një bashkëpunim të ngushtë në mes të Republikës së Kosovës dhe të Hungarisë, ku vlen të theksohet se shteti hungarez ka afuar 30 bursa për qytetarët e Kosovës për të studiuar në Hungari dhe theksoi se ka zhvillim të madh edhe sa i përket raporteve ekonomike.

Tha se të dy palët kanë konfirmuar se do të jenë në grupin e miqësisë ndërmjet dy parlamenteve dhe shprehu mendimin se është një segment i rëndësishëm, sepse e fuqizon diplomacinë parlamentare.

Elmi Reçica duke u ndërlidhur me parafolësen tha se duhet sa më shpejt t'i formojmë grupet e miqësisë. Atje kemi parë rëndësinë e këtyre grupeve. Lidhur me vizitën zyrtare njoftoi se në të gjitha takimet e zhvilluara, të gjithë zyrtarët kanë qenë për proceset që e çojnë Kosovën përpara, duke e ri konfirmuar mbështetjen e ofruar deri më tani. Nga ne tha se është kërkuar që të jemi më aktiv sa i përket diplomacisë parlamentare, si dhe në aspektin e investimeve ekonomike.

Enver Hoxhaj lidhur me grupet e miqësisë tha se duhet të formohen edhe me vendet e tjera dhe i njoftoi se grupet parlamentare kanë bërë propozime se cilat shtete do të duhej të kishin interes t'i mbulojnë.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet informata nga vizita zyrtare e delegacionit të Komisionit për Punë të Jashtme në Republikën e Italisë dhe Hungarisë nga data 8 - 11 mars 2016.

6. Dëgjimi i kandidatëve të propozuar për pozitën e ambasadorit

Komisioni në vazhdim të punës së tij dëgjoi në seanca dëgjimore, katër kandidatët e propozuar për pozitën e ambasadorit. Seancat dëgjimore u mbajtën të mbyllura, për të cilat Komisioni do të hartojë raport në besim për Presidenten, Kryeministrin dhe Ministrin e Jashtëm.

7. Të ndryshme

Blerta Deliu-Kodra I njoftoi për takimin e Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve, ku është diskutuar për projektligjet që janë në procedurë. Në këtë takim ajo tha se është marrë qëndrim që Projektligji për Shërbimin e Jashtëm të shqyrtohet në procedurë të shpejtë.

Elmi Reçica lidhur me grupet e miqësisë njoftoi se është takuar me nënkryetarin e Kuvendit z. Haliti, dhe ai ka deklaruar se grupet e miqësisë janë të gatshme, ka mbetur të vendoset se kush do t'i udhëheq ato.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Enver Hoxhaj